



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**

**VENDIM**

***Nr. 102 Datë 19.07.2012***

**PËR**

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE MIDIS OST SH.A DHE CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “a” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës \_\_.07.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarja sh.a,

Konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike duke ditur që OST sh.a është licencuar për aktivitetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.03.2009, Cez Shpërndarja sh.a është licencuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 58 datë 03.06.2008.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar.
- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontratë.

Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve,

**Vendosi :**

1. Miratimin e marrëveshjes së Shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a për vitin 2012 me ndryshimet si më poshtë:

Pikat 5.13 formulohet si më poshtë :

**“Pika 5.13**

Në rast kur CEZ Shpërndarje sh.a nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonese, por jo më shumë se vlera e vetë faturës”.

2. **Pika 5.14** hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.
3. **Pika 5.15** hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**